



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKU KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
Zyra e Kryeministrit - Urad Premsijera
Office of the Prime Minister

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2018





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada -Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of
Statistics

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2018

Prishtinë
Qershor 2019

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

RAE - Rom, Ashkali dhe Egjiptian

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

IOM - Organizata Ndërkombëtare për Migrim

UNHCR- Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

EUROSTAT- Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian

EFTA - Asociacioni i Tregtisë së Lirë të Evropës

0 - E dhëna është më e vogël se 0,5 e njësisë së dhënë të matjes

: - Mungojnë të dhënat

- - Nuk ka dukuri

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Qershor, 2019

© : Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,

ku mund të qasenë përmes veb-faqes së ASK-së

në internet <http://ask.rks-gov.net/>

P a r a t h ë n i e

Vlerësimi i popullsisë së Kosovës është raport i rregullt vjetor që si qëllim ka të sigurojë një vlerësim të saktë statistikor mbi popullsinë, i nevojshëm për institucione, organizata dhe individë, njëherit praktikë dhe standard që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi.

Kjo për arsye se në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, komune a vendbanimi dhe vlerësimi i popullsisë është më se i nevojshëm për nxjerrjen e indikatorëve të rëndësishëm socio-ekonomik. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) do të vazhdojë të bëjë vlerësimin, çdo vit, të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune. Të dhënat vjetore statistikore mbi popullsinë janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash me çështjet sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara komunale, kombëtare dhe rajonale.

Të dhënat mbi popullsinë janë një emërues dhe tregues i rëndësishëm i vendimmarrësve, analistëve, hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të ndryshëm të të dhënave. Të dhënat mbi popullsinë përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimet e llogarive kombëtare, punësimit, ndarjeve buxhetore, standardit jetësor dhe çështjeve të tjera socio-ekonomike. Këto janë të dhënat e fundit zyrtare, të vlerësuara për numrin e popullsisë së Kosovës në nivel të komunave për vitin 2018.

Raporti është përgatitur nga:

Avni Kastrati, Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale

Valdete Navakazi, Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave të Popullsisë

Saniye Uka, Zyrtare e Lartë e Statistikave të Popullsisë

Arijeta Sojeva, Zyrtare e lartë e Statistikave Vitale

Elvira Tahiri, Zyrtare e Statistikave të Popullsisë

Vjollca Berisha, Zyrtare e Statistikave të Popullsisë

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

Përmbajtja

H Y R J E	5
Për shfrytëzuesit e të dhënave	5
Baza mbi vlerësimin e popullsisë.....	5
Vështrim metodologjik	5
Burimet e të dhënave	6
Popullsia bazë	6
Lindjet:	6
Vdekjet:	7
Shënim:	7
Shtimi natyror:	7
Migrimi	8
Imigrimi ndërkombëtar:	8
Emigrimi ndërkombëtar:	8
Migrimi kombëtar:	8
Rritja e përgjithshme.....	8
Tab. 1. Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2018 në nivel të komunave	9
Tab. 2. Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2018 në nivel të komunave.....	10
Tab. 3. Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2018 në nivel të komunave	11

HYRJE

Për shfrytëzuesit e të dhënave

Raporti përfshin ndryshimet e numrit të popullsisë (shtimin natyror dhe migrimin) gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2018 në territorin e Kosovës.

Baza mbi vlerësimin e popullsisë

Në përgatitjen e këtij Vlerësimi, ASK-ja ka aplikuar metodat e praktikuara mbi vlerësimin e popullsisë, që aplikohen nga institucionet statistikore, duke shfrytëzuar burimet e ndryshme. Baza e të dhënave për ta vlerësuar numrin e popullsisë për vitin 2018, është marrë numri i vlerësuar i popullsisë rezidente në Kosovë, në fund të vitit 2017.

Vështrim metodologjik

Për ta vlerësuar numrin e popullsisë rezidente në nivel kombëtar/komunal, popullsia është e ndikuar nga nataliteti, mortaliteti dhe migrimi. (NMM).

Vlerësimi i popullsisë: popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi i jashtëm/brendshëm.

Të dhënat e vlerësuara përfundimtare mbi numrin e popullsisë në nivel të komunave janë llogaritur sipas procedurave të mëposhtme:

$$P_n + (N-M)+(I-E)$$

P_n -Numri i banorëve të përlogaritur për vitin e dhënë/paraprak (2017)

N -Numri i lindjeve të gjalla (Nataliteti), 01 janar-31 dhjetor 2018

M -Numri i vdekjeve (Mortaliteti), 01 janar-31 dhjetor 2018

I - Imigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2018

E –Emigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2018

Burimet e të dhënave

Janë shfrytëzuar burime të ndryshme statistikore ne hartimin e këtij raporti si: Vlerësimi i vitit 2017, baza e të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë 2011, bazat e shënimeve nga Statistikat e Lindjeve dhe Vdekjeve (ASK), të dhënat administrative (përfshi bazat nga hulumtimet e ASK-së) të dhënat nga komunat e Kosovës, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM-Zyra e Kosovës), Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR-Zyra e Kosovës) baza e shënimeve nga Eurostati, Frontex si dhe disa zyra statistikore dhe ato të migrimit nga disa shtete, ku ishte më i shprehur emigrimi kosovar.

Po ashtu, të dhëna të rëndësishme janë marre nga institutet statistikore të 12 shteteve (për migrimin) ku është vlerësuar se ka migruar me shume popullsia Kosovare përfshi disa ambasada të shteteve të ndryshme në Kosove.

Po ashtu, janë shfrytëzuar të dhënat e tjera administrative nga institucionet vendore, anketat, raportet dhe hulumtimet e tjera. Këto të dhëna janë analizuar sipas metodave statistikore, duke shërbyer si instrumente dhe shënime të rëndësishme statistikore për vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi dhe në nivel të komunave.

Popullsia bazë

Sipas “Vlerësimi të popullsisë për vitin 2017” numri i popullsisë rezidente në Kosovë në fund të vitit 2017 është vlerësuar gjithsej 1,798,506 banorë rezident numër i cili është marre si e dhënë bazike për të vlerësuar numrin e popullsisë për vitin 2018.

Lindjet: sipas të dhënave nga baza e shënimeve të ASK-së numri i lindjeve të regjistruara për vitin 2018 ishte gjithsej 29,080¹ prej tyre 110 lindje të vdekura derisa me vendbanim të përhershëm të nënës në Kosovë (te deklaruar si rezident) lindje të gjalla ishin gjithsej 28,7000 lindje. Ky numër i rasteve të lindjeve është marre si bazë në vlerësimin e popullsisë rezidente në Kosovë duke vlerësuar/shtuar edhe numrin e lindjeve tek komuniteti serb (përveç atyre që ishin regjistruar).

¹ <http://ask.rks-gov.net/media/4848/statistikat-e-lindjeve-2018.pdf> (faqe 10) Tabela 1. Të lindurit¹ sipas vendit ku ka ndodhur lindja dhe vendit të përhershëm të nënës në komunë, 2018

Vdekjet: bazuar në të dhënat nga baza e shënimeve të ASK, numri i vdekjeve (të regjistruara) për vitin 2018, ishte gjithsej 9,991² vdekje prej tyre me vendbanimin rezident në Kosovë (deklaruar) ishin 9,947 raste të vdekjeve. Ky numër i rasteve të vdekjeve është marre si bazë në vlerësimin e popullsisë rezidente në Kosovë duke vlerësuar/shtuar edhe numrin e vdekjeve tek komuniteti serb (përveç atyre që ishin ç’ regjistruar).

Shënim: Tek rastet e lindjeve dhe vdekjeve nga komuniteti serb, një pjesë e tyre e konsiderueshme regjistrohet derisa, një pjesë e tyre (*sidomos komunat në pjesën veriore të Kosovës nuk i regjistrojnë/raportojnë një pjese te rasteve e lindjeve dhe vdekjeve*). Bazuar në shtimin natyror të komunitetit serb në pjesën tjetër të Kosovës dhe në regjion numri i rasteve të lindjeve dhe vdekjeve (të pa raportuara) është marre shkalla e fertiliteti dhe shkalla e vdekshmërisë për komunitetin serb dhe ASK-ja ka bërë vlerësim për komunitetin në fjalë për rastet e pa raportuara (nën-regjistrim).

Po ashtu, një numër i konsiderueshëm i rasteve të lindjeve që kanë ndodhur jashtë Kosovës vlerësohet se nuk janë rezident në Kosovë por për shkak se prindërit e tyre janë deklaruar si rezident në Kosovë ASK-ja ka marre numrin e tyre ashtu siç janë të dokumentuara por vlerëson se numri i lindjeve që kanë vendbanimin rezident në Kosovë është me i vogël. Po ashtu, numri i vdekjeve të popullsisë rezidente vlerësohet të jete me i vogël marre parasysh se shume raste të vdekjeve edhe pse nuk ishin rezident në Kosovë ata janë regjistruar si raste të vdekjeve në Kosovë.

Shtimi natyror: popullsia e Kosovës gjatë vitit 2018 është rritur për 18,562 banorë apo kishte rritje vjetore prej 1.02%.

² <http://ask.rks-gov.net/media/4881/statistikat-e-vdekjeve-2018.pdf> faqe 10, Tabela 1. Vdekjet¹ sipas vendit ku ka ndodhur ngjarja dhe vendit të përhershëm në komunë, 2018.

Migrimi

Imigrimi ndërkombëtar: sipas të dhënave nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), UNHCR, IOM, të dhënat nga disa komuna dhe data bazës së Eurostat-it numri i imigrantëve në Kosovë, gjatë vitit 2018 është vlerësuar gjithsej 6,762 banorë. Në këtë numër janë përfshirë të kthyerit / riatdhesuarit, numri i azilkërkuesve të Kosovës që kanë fituar të drejtën e nënshtetësisë, ata që kanë fituar nënshtetësinë dhe janë rezident në Kosovë si dhe leje qëndrimit për here të pare me më shumë se një (1) vit qëndrimi në Kosovë.

Emigrimi ndërkombëtar: numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2018 është vlerësuar të jetë gjithsej 28,164 banorë përfshirë emigrantët legalë dhe ata ilegalë.

Pjesa më e madhe e emigrantëve për vitin 2018, ishin emigrantët *legal*. Emigrimi legal ishte për shkak të: bashkimit familjar, martesave, gjetja e një vendi pune, shpërngulje të përhershme (kryesisht në shtete fqinje), studime afatgjata me punësim etj. Po ashtu, gjatë vitit 2018 një numër emigruan duke kërkuar azil (*aplikuesit për herë të parë*) në vendet e BE-së përfshirë vendet e Asociacionit të Tregtisë së Lirë të Evropës (EFTA)-ës. Përveç vendeve të BE-së dhe EFTA-së një numër i kosovare kishte emigruar edhe në vende të tjera kryesisht në SHBA, Kanada, Turqi dhe vende tjera. Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2018 ishte -21,402 banorë.

Migrimi kombëtar: gjatë vitit 2018, vlerësohet se një numër i konsiderueshëm i popullsisë rezidente në Kosovë ka ndërruar vendbanimin (komunën) për arsye të ndryshme kryesisht nga vendbanimet rurale në ato urbane dhe surb-urbane. Numri i personave që kanë ndërruar vendbanimin nga komuna e mëparshme (nga një komunë në komunë tjetër-brenda Kosovës) është vlerësuar të jetë gjithsej 8,967 banorë (bazuar në trendin e martesave, lëvizjet në periudhën 5 vjeçare: 2005-2010 të nxjerra nga baza e regjistrimit të popullsisë si dhe numrin e nxënëseve që kanë ndërruar komunën e vendbanimit rezident).

Rritja e përgjithshme; përkundër shtimit natyror pozitiv të popullsisë me 18,562 banorëve për shkak të emigrimit të popullsisë e Kosovës në vitin 2018 kishte një rënie të numrit të përgjithshëm. Popullsia rezidente e Kosovës, për periudhën 01 janar–31 dhjetor 2018 u zvogëlua për -2,840 banorë apo me -0.16%. Popullsia në Kosovë për vitin 2018 vlerësohet të jetë 1,795,666 banorë rezident.

Tab. 1. Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2018 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2017)	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë			Gjithsej popullsia dhe shtimi natyror (31.12. 2018)
			Lindjet / Nataliteti (2018)	Vdekjet / Mortaliteti (2018)	Shtimi natyror (2018)	
1	Deçan	41,808	532	195	337	42,145
2	Gjakovë	95,340	1,362	568	794	96,134
3	Glllogoc	61,133	946	251	695	61,828
4	Gjilan	80,162	1,485	653	832	80,994
5	Dragash	34,316	557	327	230	34,546
6	Istog	40,380	571	248	323	40,703
7	Kaçanik	34,206	540	182	358	34,564
8	Klinë	40,122	740	223	517	40,639
9	Fushë Kosovë	38,607	859	212	647	39,254
10	Kamenicë	30,750	399	284	115	30,865
11	Mitrovicë	69,346	1,248	477	771	70,117
12	Mitr. e Veriut	12,211	174	183	-9	12,202
13	Leposaviq	13,587	95	66	29	13,616
14	Lipjan	57,733	956	331	625	58,358
15	Novobërdë	7,160	95	56	39	7,199
16	Obiliq	19,144	358	91	267	19,411
17	Rahovec	59,102	934	302	632	59,734
18	Pejë	99,568	1,371	625	746	100,314
19	Podujevë	83,445	1,317	349	968	84,413
20	Prishtinë	211,755	3,458	969	2,489	214,244
21	Prizren	191,565	2,960	1,062	1,898	193,463
22	Skenderaj	52,343	886	256	630	52,973
23	Shtime	27,654	444	230	214	27,868
24	Shtërpcë	6,773	135	115	20	6,793
25	Suharekë	60,247	1,132	351	781	61,028
26	Ferizaj	103,003	1,841	535	1,306	104,309
27	Viti	47,615	802	274	528	48,143
28	Vushtrri	64,468	1,170	434	736	65,204
29	Zubin Potok	6,616	94	49	45	6,661
30	Zveçan	7,376	61	26	35	7,411
31	Malishevë	58,269	1,143	217	926	59,195
32	Junik	6,370	47	25	22	6,392
33	Mamushë	5,950	84	19	65	6,015
34	Hani i Elezit	9,998	131	105	26	10,024
35	Graçanicë	12,091	44	69	-25	12,066
36	Ranillug	3,810	83	84	-1	3,809
37	Partesh	1,730	55	42	13	1,743
38	Klllokot	2,753	45	107	-62	2,691
Gjithsej		1,798,506	29,154	10,592	18,562	1,817,068

Tab. 2. Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2018 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2017)	Migrimi ndërkombëtar (2018)			Migrimi kombëtar (2018)			Bilanci i përgjithshëm i migrimit në nivel të komunave 2018	Gjithsej popullsia dhe migrimi (31.12 2018)
			Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit ndërkombëtar	Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit kombëtar		
1	Deçan	41,808	34	67	-33	132	174	-42	-75	41,733
2	Gjakovë	95,340	443	1,641	-1,198	266	362	-96	-1,294	94,046
3	Glllogoc	61,133	61	756	-695	241	404	-163	-858	60,275
4	Gjilan	80,162	596	2,874	-2,278	315	398	-83	-2,361	77,801
5	Dragash	34,316	164	383	-219	64	146	-82	-301	34,015
6	Istog	40,380	183	188	-5	197	167	30	25	40,405
7	Kaçanik	34,206	66	125	-59	114	223	-109	-168	34,038
8	Klinë	40,122	199	551	-352	226	259	-33	-385	39,737
9	Fushë Kosovë	38,607	397	1,436	-1,039	922	193	729	-310	38,297
10	Kamenicë	30,750	26	1,282	-1,256	141	296	-155	-1,411	29,339
11	Mitrovicë	69,346	169	956	-787	258	340	-82	-869	68,477
12	Mitr. e Veriut	12,211	39	86	-47	7	9	-2	-49	12,162
13	Leposaviq	13,587	109	258	-149	13	11	2	-147	13,440
14	Lipjan	57,733	147	694	-547	269	373	-104	-651	57,082
15	Novobërdë	7,160	36	97	-61	76	42	34	-27	7,133
16	Obiliq	19,144	66	793	-727	163	187	-24	-751	18,393
17	Rahovec	59,102	87	1,696	-1,609	161	263	-102	-1,711	57,391
18	Pejë	99,568	234	1,402	-1,168	286	317	-31	-1,199	98,369
19	Podujevë	83,445	459	1,431	-972	160	808	-648	-1,620	81,825
20	Prishtinë	211,755	797	1,389	-592	2,239	1,203	1,036	444	212,199
21	Prizren	191,565	627	1,659	-1,032	675	394	281	-751	190,814
22	Skenderaj	52,343	87	283	-196	219	521	-302	-498	51,845
23	Shtime	27,654	240	679	-439	152	156	-4	-443	27,211
24	Shtërpcë	6,773	21	35	-14	39	55	-16	-30	6,743
25	Suharekë	60,247	56	1,958	-1,902	191	259	-68	-1,970	58,277
26	Ferizaj	103,003	740	908	-168	466	295	171	3	103,006
27	Viti	47,615	172	563	-391	161	232	-71	-462	47,153
28	Vushtrri	64,468	173	1,763	-1,590	250	316	-66	-1,656	62,812
29	Zubin Potok	6,616	10	28	-18	7	8	-1	-19	6,597
30	Zveçan	7,376	16	30	-14	8	11	-3	-17	7,359
31	Malishevë	58,269	231	1,874	-1,643	225	307	-82	-1,725	56,544
32	Junik	6,370	15	46	-31	35	26	9	-22	6,348
33	Mamushë	5,950	8	117	-109	4	4	0	-109	5,841
34	Hani i Elezit	9,998	10	43	-33	45	51	-6	-39	9,959
35	Graçanicë	12,091	27	42	-15	204	131	73	58	12,149
36	Ranillug	3,810	5	8	-3	10	7	3	0	3,810
37	Partesh	1,730	2	7	-5	6	5	1	-4	1,726
38	Kllokot	2,753	10	16	-6	20	14	6	0	2,753
Gjithsej		1,798,506	6,762	28,164	-21,402	8,967	8,967	0	-21,402	1,777,104

Tab. 3. Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2018 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2017)	Shtimi natyror (2018)	Bilanci i migrirove (2018)	Rritja e përgjithshme për vitin 2018	Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2018 (31 dhjetor 2018 apo 01 Janar 2019)
1	Deçan	41,808	337	-75	262	42,070
2	Gjakovë	95,340	794	-1,294	-500	94,840
3	Glllogoc	61,133	695	-858	-163	60,970
4	Gjilan	80,162	832	-2,361	-1,529	78,633
5	Dragash	34,316	230	-301	-71	34,245
6	Istog	40,380	323	25	348	40,728
7	Kaçanik	34,206	358	-168	190	34,396
8	Klinë	40,122	517	-385	132	40,254
9	Fushë Kosovë	38,607	647	-310	337	38,944
10	Kamenicë	30,750	115	-1,411	-1,296	29,454
11	Mitrovicë	69,346	771	-869	-98	69,248
12	Mitr. e Veriut	12,211	-9	-49	-58	12,153
13	Leposaviq	13,587	29	-147	-118	13,469
14	Lipjan	57,733	625	-651	-26	57,707
15	Novobërdë	7,160	39	-27	12	7,172
16	Obiliq	19,144	267	-751	-484	18,660
17	Rahovec	59,102	632	-1,711	-1,079	58,023
18	Pejë	99,568	746	-1,199	-453	99,115
19	Podujevë	83,445	968	-1,620	-652	82,793
20	Prishtinë	211,755	2,489	444	2,933	214,688
21	Prizren	191,565	1,898	-751	1,147	192,712
22	Skenderaj	52,343	630	-498	132	52,475
23	Shtime	27,654	214	-443	-229	27,425
24	Shtërpçë	6,773	20	-30	-10	6,763
25	Suharekë	60,247	781	-1,970	-1,189	59,058
26	Ferizaj	103,003	1,306	3	1,309	104,312
27	Viti	47,615	528	-462	66	47,681
28	Vushtrri	64,468	736	-1,656	-920	63,548
29	Zubin Potok	6,616	45	-19	26	6,642
30	Zveçan	7,376	35	-17	18	7,394
31	Malishevë	58,269	926	-1,725	-799	57,470
32	Junik	6,370	22	-22	0	6,370
33	Mamushë	5,950	65	-109	-44	5,906
34	Hani i Elezit	9,998	26	-39	-13	9,985
35	Graçanicë	12,091	-25	58	33	12,124
36	Ranillug	3,810	-1	0	-1	3,809
37	Partesh	1,730	13	-4	9	1,739
38	Klllokot	2,753	-62	0	-62	2,691
Gjithsej		1,798,506	18,562	-21,402	-2,840	1,795,666

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

312(496.51)“2018” (084.2)

Vlerësim : popullsia e Kosovës 2018 / raporti është
përgatitur nga: Avni Kastrati... et al. - Prishtinë : Agjencia
e Statistikave të Kosovës, 2019. – 11 : ilustr. ; 28 cm.

1.Kastrati, Avni

ISBN 978-9951-22-569-4

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 155 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshafi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-569-4



9 789951 225694